

Vizioni:

Tirana, një qytet i jetueshëm dhe i aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike në nivel kapilar; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike; një qytet gjithëpërfshirës që priorizon ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

Objektivi Strategjik 1. Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike në nivel kapilar për një qytet më të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës

Objektivi Strategjik 2. Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm nëpërmjet garantimit të një ekuilibri koherent të veprimtarisë ekonomike, sociale, njerëzore dhe mjedisore.

Objektivi Strategjik 3. Transformimi i Tiranës në një qytet më të jetueshëm, të gjelbër dhe rezistent ndaj ndryshimeve klimaterike.

Objektivi Strategjik 4. Përmirësim i sistemit të shërbimeve të kujdesit social që garanton mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.

Objektivi Strategjik 5. Investim afatgjatë për rininë duke krijuar një mjedis të sigurt social dhe ekonomik, për një rini aktive dhe me akses të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre.